

ANALIZË DHE KOMENTE TË INDEP NË PROJEKTLIGJIN PËR
**PROMOVIMIN E PËRDORIMIT TË BURIMEVE TË
RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË**

Përmbajtja

Hyrje	2
Propozimet e INDEP	3
Përfundim	7

Publikim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem rikthimi ose transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mjeti, pa pëlqimin paraprak të botuesit. Publikimi mund të shpërndalet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jo komerciale.

Ky publikim u mundësua si pjesë e programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm që mbështetet nga Fondi i Vëllezërve Rockefeller. Ajo iu paraqit Komisionit parlamentar për Ekonomi në dëgjimin publik të organizuar me datë 05.12.2023 nga ana e grupit punues për amendamentimin e projektligjit. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë botim janë të autorëve. Ato jo domosdoshmërisht pasqyrojnë opinionet ose pikëpamjet RBF-së.

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore ka avokuar për një ligj të veçantë për BRE-të për një kohë të gjatë dhe në tërësinë e tij ne e mbështesim një ligj edhe iniciativë të tillë. Projektligji është i hartuar mirë dhe ofron një bazë shumë të mirë për rregullimin e mëtejshëm ligjor të një sektori që do të jetë promotor i tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit si objektiva të theksuara qartësisht në Strategjinë e Energjisë 2022-2031.

Ne konsiderojmë që një ligj i një rëndësie kaq të veçantë nuk duhej të vonohej kaq shumë. Si INDEP, kemi marrë pjesë në diskutimet për koncept dokumentin për Ligjin për Promovimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtrishme qysh në pjesën e parë të vitit 2021. Jemi të shqetësuar që Qeverisë ju deshën mbi 2 vite për të kaluar nga koncepti dokumenti në draft të Ligjit. Ky është edhe një tregues i progresit të ngadaltë e të pamjaftueshëm për të zbatuar caqet e Strategjisë dhe kriterëve evropiane për transformim të sektorit të energjisë. Shfrytëzojmë këtë platformë për të kërkuar nga ky komision i nderuar që të shtoj aktivitetet mbikëqyrëse në mënyrë që të rritet presioni pozitiv për dinamikë të shtuar të zbatimit të politikave kombëtare në fushën e energjisë.

Projektligji në përgjithësi përmbush nevojat aktuale të Kosovës. Ai synon të krijojë një kornizë gjithëpërfshirëse për rritjen e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Objektivat e tij parësorë janë të rrisë përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë dhe të bashkëprodhimit në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen, ftohjen dhe transportin. Projektligji është i rëndësishëm për të përmbushur nevojat për energji, për të forcuar sigurinë energjetike, për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit, për të ofruar përfitime sociale dhe shëndetësore dhe për të inkurajuar mundësi të barabarta punësimi në sektorin e energjisë. Për më tepër, ligji përputhet pjesërisht me Direktivën e BE-së 2018/2001, duke theksuar angazhimin e tij për integrimin e standardeve evropiane. Ai përfshin zhvillimin e politikave energjetike dhe kornizave rregulluese që mbështesin energjinë e ripërtëritshme, duke përfshirë vendosjen e një objektivi të detyrueshëm për pjesën e energjisë së ripërtëritshme në konsumin e përgjithshëm të energjisë në Kosovë deri në vitin 2030, dhe vendosjen e përgjegjësisë, të drejtave dhe mekanizmave konkurrues për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të bazuara në burimet e ripërtëritshme.

Megjithatë, si INDEP, konsiderojmë që janë disa elemente të Ligjit të cilat duhet të shtohen apo amandamentohen në mënyrë që Ligji t'i shërbej edhe më mirë objektivës kryesore të tij dhe synimeve kombëtare në fushën e energjisë.

Propozimet e INDEP

Propozimi 1

Në nenin 4 – Politikat e energjisë, ne propozojmë që pas 1.9. të shtohet paragrafi 1.10. me këtë përbajtje:

1.10. Rritja e efijencës së energjisë së bashku me përdorimin e energjisë së rinovueshme

Me këtë, ne forcojmë fokusin në efijencën e energjisë krahas rritjes së përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme. Kjo qasje siguron që zhvillimi i qëndrueshëm i Republikës së Kosovës të arrihet jo vetëm përmes shtimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, por edhe përmes një përpjekjeje të përbashkët për të optimizuar përdorimin e energjisë, duke realizuar kështu një përfitim të dyfishtë të qëndrueshmërisë mjedisore dhe kosto-efektivitetit.

Ky amendament është në përputhje edhe me kërkesën e Direktivës 2023/2413 të BE-së , në paragrafin 15 të së cilës theksohet që duhet siguruar që masat për burimet e ripërtrishme të energjisë "kontribuojnë në zbatimin e parimit të parë të efijencës së energjisë".¹

Propozimi 2

Pas nenit 9 ne propozojmë të shtohet neni 10 apo neni 9a për qëllime teknike të ruajtjes së strukturës së referimit brenda Ligjit, me këtë përbajtje:

Neni 9a - Detyrimi për të publikuar kapacitete teknike dhe mundësitë e investimit

1. Kompanitë energjetike, veçanërisht ato të përfshira në shpërndarje dhe transmetim, janë të mandatuara që të vënë në dispozicion të publikut harta të detajuara të kapaciteteve teknike për konsumatorët dhe investimet e mundshme për të gjithë nivelet e investimit në energjinë e ripërtrishme në të gjitha rajonet dhe lokalitetet e Kosovës.

2. Brenda tre (3) muajve pas miratimit të këtij ligji, Ministria harton një udhëzim administrativ që specifikon kërkesat për kompanitë energjetike në lidhje me publikimin e kapaciteteve teknike dhe mundësive për investime.

Neni 9a i propozuar mbështetet nga direktiva, raporte kyçe dhe iniciativa tjera të Bashkimit Evropian. Angazhimi i Bashkimit Evropian ndaj Marrëveshjes së Gjelbër dhe përqendrimi i shtuar në energjinë e ripërtrishme si një element vendimtar në reduktimin e emetimeve të

¹ Bashkimi Evropian (2023), Direktiva (Be) 2023/2413 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 18 tetor 2023 që ndryshon Direktivën (BE) 2018/2001, Neni 15 e qasshme në [Directive \(EU\) 2023/2413 of the European Parliament and of the Council of 18 October 2023 amending Directive \(EU\) 2018/2001, Regulation \(EU\) 2018/1999 and Directive 98/70/EC as regards the promotion of energy from renewable sources, and repealing Council Directive \(EU\) 2015/652 \(europa.eu\)](#), (qasur në dhjetor, 2023)

gazeve serrë përputhet me frymën e nenit 9a. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin perëndimor bënë thirrje për fuqizim të investimeve në burime të ripërtrishme të energjisë.²

Plani REPowerEU thekson më tej nevojën për energji të erës dhe diellore dhe rritjen e shkallës së përdorimit të energjisë së rinovueshme, si dhe zgjerimin e kapacitetit për të mbështetur prodhimin më të lartë të karburanteve të ripërtrishme. Ky plan, i cili synon pavarësinë e BE-së nga karburantet fosile përpara vitit 2030, nënvizon domosdoshmërinë që shtetet anëtare dhe anëtarët aspirantë si Kosova të zhvillojnë korniza të fuqishme dhe transparente për promovimin e energjisë së ripërtrishme.

Për më tepër, raporti i Komisionit Evropian për Kosovën pranon progresin e bërë në sektorin e energjisë, duke përfshirë miratimin e një strategjie energjetike për 2022-2031. Megjithatë, ai vë në dukje gjithashtu mungesën e konsensusit për shumë çështje, duke përfshirë politikën energjetike, duke sugjeruar nevojën për informacion më të detajuar dhe transparent për të nxitur marrëveshjen dhe vendimmarrjen e informuar.

Propozimi 3

Ne propozojmë që formulimi në nenin 13, paragrafi 2: “Prodhuesi i Privilegjuar nuk përdor energjinë elektrike të tërhequr nga sistemi energjetik për mbushjen e sistemit të ruajtjes.” është kufizues dhe dëmton hapjen e tregut, është në shpërputhje me Direktivën e BE-së dhe duhet të hiqet.

Kjo klauzolë aktualisht ndalon prodhuesit e privilegjuar që të përdorin energjinë elektrike të nxjerrë nga sistemi energjetik për ngarkimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë. Ne besojmë se ky ndryshim është thelbësor për arsyet e mëposhtme:

- > Fleksibilitet dhe eficiencë e shtuar në ruajtjen e energjisë: Lejimi i pronarëve të sistemeve të ruajtjes së energjisë që të blejnë energji elektrike gjatë periudhave të furnizimit të tepërt, siç është nata, përputhet me frymën e Direktivës për eficiencën e sistemit. Heqja e këtij kufizimi mundëson që energjia të mos harxhohet kot dhe të ruhet në kohë me kërkesë të lartë, duke kontribuar në sigurinë dhe eficiencën e rrjetit e rrjetit.
- > Direktiva evropiane inkurajon Shtetet Anëtare dhe ato aspirante të mbështesin investimet në energjisë e ripërtrishme dhe infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë ruajtjen e energjisë si një mjet fleksibiliteti. Duke lejuar ngarkimin e sistemeve të ruajtjes me energji elektrike nga rrjeti, mundësohet rritja e kapacitetit për të integruar burimet e ripërtrishme të energjisë, duke mbështetur synimin kryesor të dekarbonizimit deri në vitin 2050.
- > Heqja e këtij kufizimi gjithashtu nxit inovacionin në sektorin e energjisë, duke inkurajuar zhvillimin e teknologjive dhe zgjidhjeve të reja të ruajtjes. Kjo përputhet me theksin e

² Bashkimi Evropian, (2020), Deklarata e liderëve të WB-6 për agjendën e gjelbër, Shtylla 1, e qasshme në [Regional Cooperation Council | Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans \(rcc.int\)](#) (qasur në dhjetor, 2023)

- > Direktivës mbi inovacionin si një faktor kyç në konkurrencën e energjisë së rinovueshme.

KOMENT

Në lidhje me nenin 16 – Dizajni dhe zbatimi i procesit të ofertimit konkurrues, siç e dimë, Qeveria e Kosovës tashmë ka hapur ankandin konkurrues i cili ka pësuar disa shtyerje të një pas njëshme. Ne kërkojmë sqarim nga Qeveria nëse kërkesat e ankandit janë të barasvlefshme me nenin 16 të këtij projektligji. Duke qenë Projektligji i vonuar, është thelbësore për ne të kuptojmë nëse procesi i tenderit konkurrues për këtë ankand integron përcaktimet e detajuara të përcaktuara në këtë draft ligj.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ankandi në vendosjen e Kosovës në hartën e tërheqjes së kapitalit privat për tranzicionin e gjelbër dhe rolin e saj në zbutjen e ndryshimeve klimatike, është e domosdoshme që qeveria të japë qartësi nëse këto elemente janë përfshirë në thirrjen publike.

Propozimi 4

Tek neni 23, ne kundërshtojmë themelimin e një Operatori shtesë të energjisë pa adresuar më parë çështjen ekzistuese të Kompanisë së Re Energjetike të Kosovës (NKEC). NKEC, e krijuar për projektin e termocentralit "Kosova e Re" – projekt i cili është anuluar - nuk ka filluar funksionimin efektiv dhe nuk ka mbuluar asnjë pjesë të tregut të energjisë në vend. Në dritën e anulimit të projektit, rekomandimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2020 theksonte nevojën për një vizion të qartë të së ardhmes për NKEC, duke qenë se qëllimi i tij i vetëm ishte i lidhur me projektin "Kosova e Re". Përkundër kësaj, mosveprimi i Qeverisë qoftë në mbylljen e NKEC apo ripërcaktimin e rolit të saj në tregun e energjisë ka rezultuar që ajo të bëhet barrë financiare për buxhetin e Kosovës. Shpenzimet për anëtarët e bordit dhe pagat e stafit, duke përfshirë pagën mujore të konsiderueshme të Drejtorit Ekzekutiv, në total rreth 96 mijë euro në vitin 2022, janë një shpenzim i pajustificueshëm për një subjekt jo-operativ. Kështu, ne argumentojmë se themelimi i një Operatori të ri të Energjisë së Ripërtrishme duhet të kushtëzohet me zgjidhjen e çështjes së NKEC apo të njëjtës t'i ipet statusi i ri bazuar në dispozitat e këtij projektligji. Vetëm në këtë mënyrë mund të parandalojmë barrë të mëtejshme të panevojshme financiare në buxhetin e Kosovës dhe të sigurojmë adresim të përgjegjshëm për dëmin financiar që ende është duke i shkaktuar buxhetit të Kosovës ndërmarrja NKEC.

Propozimi 5

Ne propozojmë një ndryshim në nenin 40 që ka të bëjë me Masat për rritjen e pjesës së Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes. Ne sugjerojmë që në paragrafin e par të këtij neni të zvogëlohet afati kohor për Ministrinë për të vendosur masa që promovojnë zhvillimin e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes nga dymbëdhjetë (12) muaj në gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit. Së pari, afati prej 6 muajsh është mëse i mjaftueshëm dhe përputhet me nevojën urgjente për të pasur këto masa për sezonin e dimrit 2024/25. Ky afat kohor është thelbësor për të siguruar që sektori i ngrohjes dhe ftohjes mund të përgatitet dhe përshtatet në mënyrë adekuate me rregulloret e reja dhe kërkesat e infrastrukturës, duke e parë gjithashtu një trend në rritje të investimeve të qytetarëve në këtë fushë.

Së dyti, shkurtimi i afatit në gjashtë muaj pasqyron nevojën urgjente për të plotësuar bazën ligjore për zhvillimin e energjisë së rinovueshme pa vonesa të mëtejshme. Maftueshëm është vonuar Ligji dhe nuk ka nevojë që edhe aktet nënligjore të na marrin vite për hartim.

Për arsyet e njëjta ne propozojmë edhe shkurtimin e afatit nga 12 muaj në 6 muaj në Nenin 44 - Masat për rritjen e pjesës së energjisë së Ripërtërishme në sektorin e transportit.

Shkurtimi i afateve është në përputhje edhe me nenin 66 të Projektligjit që kërkon që: “Ministria, Rregullatori apo cilido subjekt tjetër varësisht nga rasti, janë të detyruar t’i miratojnë dhe harmonizojnë aktet nënligjore për zbatimin e kërkesave të këtij ligji, brenda nëntë (9) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur ky ligj kërkon miratim të mëhershëm.

Propozimi 6

Të shtohet kufizimi kohor në paragrafin 2 të nenit 46 të projektligjit që thotë:

Kriteret për qëndrueshmërinë dhe kursimet e emisioneve të gazrave serë të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Ministria përgjegjëse për mjedisin, sipas legjislatcionit përkatës në fuqi si dhe në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

INDEP propozon që në fund të fjalisë të shtohet **“më së largu gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.**

Në këtë mënyrë vihet në dukje nevoja për dinamikë të shtuar për zhvillimin e sektorit. Lënja pa afat për miratimin e akteve nënligjore rrezikon neglizhim të mëtejshëm dhe mos përmbyllje të kuadrit ligjor.

Propozimi 7

INDEP kërkon të rishikohet tërësisht neni 52 i Ligjit mbi One-Stop Shop-in.

Themelimi i One-Stop shop në fushën e burimeve të ripërtrishme të energjisë ishte kërkesë qysh e Ligjit për Energjisë në kuadër të pakos së tretë të legjislacionit në fushën e energjisë të Bashkimit Evropian. Në vitin 2017, ka pasur një draft të udhëzimit administrativ NR. 09/2017 për Themelimin e One-Stop-Shop për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë³ Ne si INDEP e kemi kundërshtuar formën e menduar të One-Stop-Shop pasi natyra e saj i ngjasonte një zyreje të informimit dhe informatat apo shërbimet që i ofronte, në situatë normale duhej të ofroheshin në një uebsajt. Ne argumentuam që një One-stop-shop efektiv duhej të përbëhej nga përfaqësues të të gjitha institucioneve që përfshihen në procedurën e licencimit, të kishte mini-departamente të tyre brenda One-Stop-Shopit (përveç komunave) dhe e gjithë procedura e licencimit të kryhej brenda kësaj zyreje. Përveç kësaj, ne propozojmë që e gjithë hulumtimi i kapaciteteve dhe përgatitja e dokumentacionit teknik për proceset e ankandit të kryhen nga kjo zyrë. Investitori me rastin e paraqitjes të arrij që brenda ditës t'i dorëzoj specifikat e ofertës së vet bazuar në një dokumentacion, pjesa më e madhe e së cilës është përgatitur tashmë nga One-Stop-Shopi.

Neni 52 i Projektligjit, për fat të keq nuk avancoi në këtë drejtim dhe përcaktoi që ajo është vetëm një pikë kontakti për lehtësim dhe koordinim. Për më tepër, janë paraparë gjashtë (6) muaj kohë për Ministrinë që të hartoj akt nënligjor i cili tashmë siç e thamë ekziston që nga viti 2017. INDEP propozon që grupi punues të rishikoj nenin 52 duke e konsideruar një rol serioz aktiv të One-Stop-Shopit dhe jo thjeshtë një pikë kontakti. Gjithashtu, propozojmë që aktet nënligjore në lidhje me këtë të përmyllen brenda 3 muajve dhe jo gjashtë siç e parashihet projektligji.

Përfundim

- > Në përfundim ne si INDEP shprehim përkrahjen tonë për miratimin e këtij Ligji që e përsërisim është vonuar pa shpjegim nga ana e Qeverisë së Kosovës.
- > Projektligji është hartuar në përgjithësi në përputhje me përkushtimet e Kosovës në Strategjinë e Energjisë dhe i ndihmon tranzicionit të domosdoshëm energjetik në vend dhe largimit nga qymyri. Për këtë, ne e përshëndesim miratimin e tij sa më parë!
- > I kërkojmë grupit të punës të shqyrtoj dhe aprovoj propozimet e INDEP në mënyrë që të avancohet edhe më shumë ky Ligj dhe të mos lëshohet shansi për të bërë përmirësime pozitive në kualitetin e tij.

³ Qeveria e Kosovës, (2017). I qasshëm në [DRAFT UDHËZIM ADMINISTRATIV \(MZHE\) NR. 09/2017 PËR THEMELIMIN E ONE STOP SHOP PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË.docx \(live.com\)](#) (qasur në dhjetor, 2023)

